Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

"MEKANIKË BUJQËSORE"

Niveli III në KSHK[1], referuar niveli III të KEK[2]

M8-III-26

Tiranë, 2026

[1] Korniza Shqiptare e Kualifikimeve
[2] Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Rr. Mustafa Lleshi, Godina e Thesarit, Kati i tretë, Tiranë Web site www.akafp.gov.al
Tel/fax.+355 42237087

Përmbajtja

Emërtimi i kualifikimit 4
Kodi..... 4
Kohëzgjatja 4
Niveli..... 4
Qëllimi 4
Kriteret e përgjithshme të pranimit 4
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit 4
Ofruesit 4
Data e validimit..... 4
Data e miratimit 4
Variantet e mëparshme 4
STRUKTURA E KUALIFIKIMIT..... 5
KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME..... 5
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL: 6
NjN-12-III-0536-26 Makinat bujqësore, pajisjet ndihmëse dhe ndërtimi i tyre 6
Rezultatet e të nxënit në njohuri 6
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale 8
Kriteret e vlerësimit 8
NjN-12-III-0537-26 Skemat kinematike, hidraulike, pneumatike, elektrike, elektronike në mjetet bujqësore..... 10
Rezultatet e të nxënit në njohuri 10
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale 10
Kriteret e vlerësimit 10
NjN-12-III-0538-26 Bazat e mekanikës për mjetet bujqësore 11
Rezultatet e të nxënit në njohuri 11
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale 11
Kriteret e vlerësimit 12
NjN-12-III-0539-26 Bazat e elektroteknikës për mjetet bujqësore 13
Rezultatet e të nxënit në njohuri 13
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale 13
Kriteret e vlerësimit 14
NjN-12-III-0540-26 Planifikimi dhe organizimi i punës në mekanikën bujqësore..... 14
Rezultatet e të nxënit në njohuri 14
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale 15
Kriteret e vlerësimit 15
NjN-12-III-0541-26 Diagnostikim i parregullsive në sistemet e makinerive bujqësore 16
Rezultatet e të nxënit në njohuri 16
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale 17
Kriteret e vlerësimit 17
NjN-12-III-0542-26 Punime saldimi dhe axhusterie në makineritë bujqësore 18
Rezultatet e të nxënit në njohuri 18
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale 19
Kriteret e vlerësimit 19
NjN-12-III-0543-26 Punime në motorët e makinerive bujqësore..... 21
Rezultatet e të nxënit në njohuri 21

Rr. Mustafa Lleshi, Godina e Thesarit, Kati i tretë, Tiranë Web site www.akafp.gov.al
Tel/fax.+355 42237087

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale 22
Kriteret e vlerësimit 22
NjN-12-III-0544-26 Punime në sistemin e transmetimit të fuqisë në makineritë bujqësore 24
Rezultatet e të nxënit në njohuri 24
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale 25
Kriteret e vlerësimit 25
NjN-12-III-0545-26 Punime në sistemin e drejtimit të makinerive bujqësore 26
Rezultatet e të nxënit në njohuri 26
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale 27
Kriteret e vlerësimit 27
NjN-12-III-0546-26 Punime në sistemin e frenimit të makinerive bujqësore 28
Rezultatet e të nxënit në njohuri 28
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale 29
Kriteret e vlerësimit 29
NjN-12-III-0547-26 Punime në sistemin e varjes dhe të ecjes së makinerive bujqësore 30
Rezultatet e të nxënit në njohuri 30
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale 31
Kriteret e vlerësimit 31
NjN-12-III-0548-26 Punime në sistemin hidraulik dhe pneumatik të makinerive bujqësore 32
Rezultatet e të nxënit në njohuri 32
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale 33
Kriteret e vlerësimit 33
NjN-12-III-0549-26 Punime në sistemet elektrike dhe elektronike në makineritë bujqësore 34
Rezultatet e të nxënit në njohuri 34
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale 35
Kriteret e vlerësimit 35
NjN-12-III-0550-26 Punime në pajisjet ndihmëse të makinerive bujqësore 36
Rezultatet e të nxënit në njohuri 37
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale 37
Kriteret e vlerësimit 37
NjN-24-III-0492-26 Sipërmarrje, komunikim dhe edukim karriere 38
Rezultatet e të nxënit në njohuri 38
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale 40
Kriteret e vlerësimit 40
NjN-12-III-0551-26 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në mekanikën bujqësore..... 41
Rezultatet e të nxënit në njohuri 41
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale 42
Kriteret e vlerësimit 43
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse..... 43
Modalitetet e vlerësimit 44
Informacion shtesë..... 45
SHËNIM 45

Rr. Mustafa Lleshi, Godina e Thesarit, Kati i tretë, Tiranë Web site www.akafp.gov.al
Tel/fax.+355 42237087

Emërtimi i kualifikimit	"Mekanikë bujqësore"			Kodi
Kohëzgjatja	3300-4500 orë nocionale	Niveli	Niveli III në KSHK, referuar niveli III të KEK	M8-III-26
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional "Mekanikë bujqësore" niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK," është të përgatisë punonjës të kualifikuar për riparimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve mekanike të makinave bujqësore dhe pajisjeve ndihmëse të tyre, si dhe të zhvillojë personalitetin e nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që e rrethon dhe përgatitja e tyre për t'u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me profilin "Mekanikë bujqësore".			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet që ofrohet kualifikimi profesional **"Mekanikë bujqësore" niveli III në KSHK**, referuar niveli III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: – kanë mbaruar arsimin bazë; – janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional; – pranohen edhe individë që kanë aftësi ndryshe, për të cilët ofruesi i kualifikimit krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë që shfaqin.			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Pas përfundimit me sukses të kualifikimit profesional "Mekanikë bujqësore", niveli III në KSHK, me kohëzgjatje 3 vite shkollore, pas përfundimit të arsimit bazë, individi pajiset me certifikatë profesionale të maturës shkollore profesionale dhe suplementin përkatës dhe del në tregun e punës si punonjës i kualifikuar. Ky arsimim i jep mundësi individit t'i drejtohet tregut të punës për punësim në subjekte të "Mekanikës bujqësore", për makina bujqësore dhe pajisje ndihmëse të tyre, si dhe në veprimtari të tjera për shërbime mekanike. Gjithashtu, individi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e mirëmbajtjes, riparimit dhe shitblerjes së pjesëve të makinave bujqësore dhe pajisjeve ndihmëse të tyre. Gjithashtu, përfundimi i këtij niveli lejon kalimin në nivel më të lartë të arsimit profesional, në nivelin IV në KSHK, arsim profesional njëvjeçar (nivel teknik/menaxherial), me qëllim përfitimin e diplomës së "Maturës Shtetërore Profesionale" ose në kursin urë, të përgjithshëm, dhe pas përfundimit të njërit nga këto kualifikime mund të vazhdojë studime pas të mesme ose universitare.			
Ofruesit	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e	**M6-III-16**			

Rr. Mustafa Lleshi, Godina e Thesarit, Kati i tretë, Tiranë Web site www.akafp.gov.al
Tel/fax.+355 42237087

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional **"Mekanikë bujqësore", niveli III në KSHK**, referuar nivelit III të KEK, individi duhet të zotërojë njohuritë, shprehitë profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas njësive të të nxënit të mëposhtme:

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënit.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij/saj dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij/saj personal dhe profesional dhe ti shpërndajë ato, në dobi të kolegëve dhe punonjësve në njësinë e tij/saj prodhuese;
3. Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
4. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
5. Të zbatojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integrimeve lokale e rajonale;
6. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij/saj;
7. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
8. Të organizojë drejtë procesin e të nxënit të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
9. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuara;
10. Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë aftësitë e tij/saj, nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij/saj;
11. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtaritë shkollore dhe në komunitet;
12. Të demonstrojë aftësinë për të pranuar dhe për të promovuar ndryshimin dhe inovacionin;
13. Të demonstrojë aftësinë për të komunikuar dhe negociuar idetë në mënyrë eficiente me të tjerët;
14. Të demonstrojë aftësinë për të menduar në mënyrë krijuese dhe novatore;
15. Të demonstrojë aftësinë për të identifikuar dhe për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet.

Rr. Mustafa Lleshi, Godina e Thesarit, Kati i tretë, Tiranë Web site www.akafp.gov.al
Tel/fax.+355 42237087

NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënit (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehi profesionale).

NjN-12-III-0536-26 Makinat bujqësore, pajisjet ndihmëse dhe ndërtimi i tyre

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë rëndësinë e makinave bujqësore dhe pajisjeve ndihmëse në veprimtarinë bujqësore;
2. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionin e një servisi për makineritë bujqësore dhe pajisjeve ndihmëse;
3. Të shpjegojë llojet e shërbimeve në makinat bujqësore dhe në pajisjet ndihmëse;
4. Të shpjegojë shkaqet e parregullsive të detaleve në makinat bujqësore dhe pajisjet ndihmëse;
5. Të listojë metodat e riparimit të detaleve të makinave bujqësore dhe pajisjeve ndihmëse;
6. Të përshkruajë veglat, pajisjet dhe instrumentet matëse dhe kontrolluese të një servisi makinash bujqësore;
7. Të përshkruajë punimet e montim/çmontim dhe riparim/zëvendësimit të detaleve dhe nyjeve në sistemet e makinave bujqësore dhe pajisjeve ndihmëse të tyre;
8. Të shpjegojë qëllimin dhe përmbajtjen e librit të shërbimeve të makinave bujqësore dhe pajisjeve ndihmëse;
9. Të klasifikojë llojet e makinave bujqësore, ndërtimin dhe funksionet e tyre;
10. Të shpjegojë parametrat teknike dhe konstruktivë të mekanizmave të makinave bujqësore;
11. Të shpjegojë sistemet dhe funksionin e tyre në makinat bujqësore;
12. Të klasifikojë llojet e motorëve me djegie të brendshme (MDB) në makinat bujqësore;
13. Të shpjegojë parametrat teknikë dhe konstruktivë të motorëve me djegie të brendshme;
14. Të përshkruajë sistemet dhe ndërtimin e motorit me djegie të brendshme (MDB) në makinat bujqësore;
15. Të shpjegojë ndërtimin dhe funksionin e cilindrit të motorit (mekanizëm bjellë-manivelë, pistonat, fashot, boshti motorik etj.);
16. Të përshkruajë elementët e sistemit të transmetimit të fuqisë, ndërtimin dhe funksionin e tyre;
17. Të klasifikojë llojet e fraksioneve, sipas ndërtimit dhe funksionit të tyre;
18. Të listojë llojet e volanteve dhe karakteristikat e tyre;
19. Të klasifikojë llojet e sistemeve të drejtimit (mekanik, hidraulik, elektro-hidraulik dhe hidrostatik) sipas ndërtimit dhe funksionit të tyre;
20. Të analizojë funksionimin e sistemit të drejtimit në makineritë bujqësore me rrota dhe

Rr. Mustafa Lleshi, Godina e Thesarit, Kati i tretë, Tiranë Web site www.akafp.gov.al
Tel/fax.+355 42237087

me zinxhir;

21. Të klasifikojë llojet e grupeve të timonit, sipas ndërtimit dhe përdorimit të tyre;
22. Të përshkruajë grupin e timonit dhe elementët përbërës të tij;
23. Të përshkruajë mekanizmat ndihmës të sistemit të drejtimit, ndërtimin dhe funksionin e tyre;
24. Të përshkruajë elementët e drejtimit hidraulik dhe hidrostatik, ndërtimin dhe funksionin e tyre;
25. Të klasifikojë llojet e sistemeve të frenimit (mekanik, hidraulik, pneumatik, elektrik dhe elektro-hidraulik) sipas ndërtimit dhe funksionimit të tyre;
26. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e sistemeve të frenimit të makinerive bujqësore;
27. Të përshkruajë elementët e sistemit të frenimit hidraulik, ndërtimin dhe funksionimin e tyre;
28. Të përshkruajë elementët e sistemit të frenimit elektrik dhe elektronik, ndërtimin dhe funksionimin e tyre;
29. Të përshkruajë sistemet elektronike ABS/ESP, ndërtimin dhe funksionin e tyre;
30. Të përshkruajë elementët e sistemit të frenimit të rimorkiove dhe sistemeve të kombinuara, ndërtimin dhe funksionin e tyre;
31. Të përshkruajë elementët e sistemit të varjes (amortizatorët, balestrat, sustat, jastëkët e ajrit) llojet, ndërtimi dhe funksioni i tyre;
32. Të përshkruajë elementët e sistemit të furnizimit me energji elektrike, ndërtimi dhe funksioni i tyre;
33. Të përshkruajë elementët e sistemit të lëshimit (startimit), manualit;
34. Të përshkruajë elementët e sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimit, ndërtimin dhe funksionimin e tyre;
35. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionin e sistemit të ecjes së traktorit me rrota dhe me zinxhirë;
36. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionin e kabinës të traktorit me rrota dhe zinxhirë;
37. Të përshkruajë rimorkiot transportuese dhe vetëshkarkuese llojet, ndërtimin dhe funksionin e tyre;
38. Të përshkruajë llojet e lubrifikantëve dhe lëngjeve, sipas karakteristikave dhe përdorimit të tyre;
39. Të listojë llojet e pajisjeve ndihmëse dhe funksionet e tyre sipas përdorimit dhe mënyrës së lidhjes me makinën bujqësore;
40. Të përshkruajë parametrat teknikë të pajisjeve ndihmëse, sipas kërkesave teknike;
41. Të përshkruajë mënyrat e regjistrimit të pajisjeve ndihmëse gjatë punimit të tokës;
42. Të përshkruaj elementët e mekanizmit të transmetimit të fuqisë të pajisjeve ndihmëse dhe mënyrat e transmetimit të fuqisë nga makina bujqësore;
43. Të listojë makinat e punimit të tokës, mbjelljes, plehërimit, mbrojtjes së bimëve, korrjes, transportit dhe grumbullimit etj.;

Rr. Mustafa Lleshi, Godina e Thesarit, Kati i tretë, Tiranë Web site www.akafp.gov.al
Tel/fax.+355 42237087

44. Të përshkruajë pajisjet ndihmëse për punimin e tokës (plugje, disqe, freza etj.) ndërtimi dhe funksioni i tyre;
45. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionin e pajisjeve mbjellëse dhe plehëruese;
46. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionin e pajisjeve të shërbimit të bimëve (spërkatëse, ujitëse, plehëruese etj.);
47. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionin e makinave të korrjes dhe mbledhjes së prodhimit bujqësor etj.;
48. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionin e rimorkiove të transportit bujqësor dhe mekanizmave vetëshkarkues;
49. Të përshkruajë procedurat e lidhjes dhe shkëputjes së pajisjeve ndihmëse me makinën kryesore (traktorin);
50. Të përshkruajë procedurat e kontrollit vizual, funksional dhe teknik të pajisjeve ndihmëse.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë kontrollin e parametrave teknike dhe konstruktivë të mekanizmave të makinave bujqësore dhe pajisjeve ndihmëse;
2. Të zbatojë metodat e riparimit të detaleve të makinave bujqësore;
3. Të përdorë mjetet, veglat e punës, instrumentet matëse e kontrolluese në servisin e makinerive bujqësore;
4. Të plotësojë librin e shërbimeve të makinave bujqësore dhe pajisjeve ndihmëse pas punimeve të kryera.

Kriteret e vlerësimit

- Përcakton rëndësinë e makinave bujqësore dhe pajisjeve ndihmëse, sipas veprimtarisë bujqësore;
- Klasifikon makinat bujqësore, sipas llojit dhe funksionit të tyre;
- Identifikon sistemet në makinat bujqësore sipas funksionit të tyre;
- Kontrollon parametrat teknike dhe konstruktivë të mekanizmave të makinave bujqësore, sipas manualit të prodhuesit;
- Përzgjedh mjetet, veglat e punës, instrumentet matëse e kontrolluese, sipas llojit të punimit;
- Përdor veglat dhe instrumentet matëse gjatë punimeve në makinat bujqësore dhe pajisjet ndihmëse, sipas procedurave teknike;
- Klasifikon motorët me djegie të brendshme (MDB) në makinat bujqësore, sipas llojit të tyre;
- Kontrollon parametrat teknikë dhe konstruktivë të motorëve me djegie të brendshme, sipas manualit të prodhuesit;
- Përcakton sistemet e motorit me djegie të brendshme (MDB) në makinat bujqësore, sipas funksionit që kryejnë;

Rr. Mustafa Lleshi, Godina e Thesarit, Kati i tretë, Tiranë Web site www.akafp.gov.al
Tel/fax.+355 42237087

- Përdor dokumentacionin teknik, manualet dhe parametrat teknikë të motorit, sipas procedurave përkatës;
- Përdor dokumentacionin teknik, manualet dhe parametrat teknikë të sistemit të transmetimit të fuqisë, sipas procedurave përkatëse;
- Klasifikon llojet e fraksioneve, sipas ndërtimit dhe funksionit të tyre;
- Klasifikon llojet e sistemeve të drejtimit (mekanik, hidraulik, elektro-hidraulik dhe hidrostatik) sipas ndërtimit dhe funksionimit të tyre;
- Përdor dokumentacionin teknik, të sistemit të drejtimit në makineritë bujqësore, sipas procedurave përkatës;
- Përdor dokumentacionin teknik, të grupit të timonit dhe elementëve përbërës të tij, sipas procedurave përkatëse;
- Identifikon mekanizmat ndihmës të sistemit të drejtimit, sipas funksionit që kryejnë;
- Përdor dokumentacionin teknik, të elementëve të drejtimit hidraulik dhe hidrostatik, sipas procedurave përkatëse;
- Identifikon sistemet e frenimit të makinerive bujqësore, sipas llojeve të tyre;
- Përdor dokumentacionin teknik, të elementëve të sistemit të frenimit hidraulik, sipas procedurave përkatëse;
- Përdor dokumentacionin teknik, të elementëve të sistemit të frenimit elektrik dhe elektronik, sipas procedurave përkatëse;
- Përdor dokumentacionin teknik, të sistemeve elektronike, sipas procedurave përkatëse;
- Identifikon elementët e sistemit të frenimit të rimorkiove dhe sistemeve të kombinuara, sipas llojit të tyre;
- Identifikon elementët e sistemit të varjes (amortizatorët, balestrat, sustat, jastëkët e ajrit) sipas llojit të tyre;
- Përdor dokumentacionin teknik, të sistemit të furnizimit me energji elektrike, sipas procedurave përkatëse;
- Përdor dokumentacionin teknik, të elementëve të sistemit të lëshimit (startimit), sipas procedurave përkatëse;
- Përdor dokumentacionin teknik, të elementëve të sistemit të ndriçimit dhe sinjalizimit, sipas procedurave përkatëse;
- Përdor dokumentacionin teknik, të sistemit të ecjes së traktorit me rrota dhe me zinxhirë, sipas procedurave përkatëse;
- Klasifikon llojet e rimorkiove transportuese dhe vetëshkarkuese, sipas funksionit;
- Plotëson librin e shërbimeve të makinave bujqësore dhe pajisjeve ndihmëse, pas punimeve të kryera;
- Klasifikon pajisjet ndihmëse dhe agregatet bujqësore, sipas funksionit dhe përdorimit të tyre;
- Kontrollon mekanizmat e lidhjes dhe tërheqjes së pajisjeve ndihmëse, sipas parametrave teknikë;

Rr. Mustafa Lleshi, Godina e Thesarit, Kati i tretë, Tiranë Web site www.akafp.gov.al
Tel/fax.+355 42237087

- Kontrollon parametrat teknikë të pajisjeve ndihmëse, sipas kërkesave teknike.

NjN-12-III-0537-26 Skemat kinematike, hidraulike, pneumatike, elektrike, elektronike në mjetet bujqësore

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë rëndësinë dhe qëllimet e vizatimit teknik;
2. Të listojë veglat dhe pajisjet e vizatimit teknik për të kryer ndërtime gjeometrike dhe vizatime të thjeshta;
3. Të përshkruajë skica detalesh duke përdorur standardet për paraqitjen;
4. Të përshkruajë shënimin e filetave sipas llojit dhe bashkimeve të thjeshta me fileto;
5. Të përshkruajë vizatimet e detaleve të makinave bujqësore dhe pajisjeve ndihmëse;
6. Të përshkruajë vizatimet e bashkimeve të çmontueshme dhe të paçmontueshme;
7. Të shpjegojë skemat statike dhe kinematike të thjeshta të sistemeve të ndryshme të makinave bujqësore dhe pajisjeve ndihmëse;
8. Të lexojë skema të thjeshta të sistemeve hidraulike të makinave bujqësore dhe pajisjeve ndihmëse;
9. Të lexojë skema të thjeshta të sistemeve pneumatike të makinave bujqësore dhe pajisjeve ndihmëse;
10. Të lexojë skema të thjeshta të sistemeve elektrike dhe elektronike të mjeteve bujqësore;
11. Të përshkruajë skema të thjeshta të paraqitura në aksonometri;
12. Të përshkruajë rëndësinë e vizatimeve me kompjuter dhe programet përkatëse.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të analizojë skemat e sistemeve të ndryshme përbërëse të makinave bujqësore dhe pajisjeve ndihmëse;
2. Të kryejë skica dhe vizatime të thjeshta të detaleve të makinave bujqësore dhe pajisjeve ndihmëse;
3. Të përdorë veglat dhe mjetet e vizatimit teknik në skicat dhe vizatimin e detaleve.

Kriteret e vlerësimit

- Përdor saktë veglat dhe pajisjet e vizatimit teknik për të kryer ndërtime gjeometrike dhe vizatime të thjeshta;
- Vizaton skica të thjeshta detalesh me vështirësisë mesatare duke përdorur simbolet, sipas standardeve përkatëse;
- Shënon përmasat e skicave të vizatuara, sipas standardeve përkatëse;
- Vizaton bashkime të thjeshta të paçmontueshme, sipas standardeve;
- Vizaton bashkime të thjeshta të çmontueshme, sipas standardeve;
- Analizon skemat statike dhe kinematike të thjeshta të sistemeve të ndryshme të makinave bujqësore dhe sistemeve ndihmese, sipas standardeve;

Rr. Mustafa Lleshi, Godina e Thesarit, Kati i tretë, Tiranë Web site www.akafp.gov.al
Tel/fax.+355 42237087

- Analizon skemat hidraulike të thjeshta të sistemeve të ndryshme të makinave bujqësore, sipas standardeve;
- Analizon skemat pneumatike të thjeshta të sistemeve të ndryshme të makinave bujqësore, sipas standardeve;
- Analizon skemat elektrike dhe elektronike të thjeshta të sistemeve të ndryshme të makinave bujqësore dhe sistemeve ndihmëse, sipas standardeve;
- Kryen vizatime të thjeshta aksonometrike, sipas standardeve.

NjN-12-III-0538-26 Bazat e mekanikës për mjetet bujqësore

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të listojë materialet që përdoren në makinat bujqësore dhe pajisjet ndihmëse, sipas proceseve të punës;
2. Të përshkruajë vetitë fizike, kimike dhe mekanike të materialeve;
3. Të përshkruajë veçoritë e metaleve, lidhjeve të metaleve dhe materialeve jometalike;
4. Të përshkruajë detalet, lidhjet dhe mekanizmat që përdoren në makinat bujqësore dhe pajisjet ndihmëse;
5. Të përshkruajë përdorimin e elementëve hidraulikë dhe pneumatikë në makinat bujqësore dhe pajisjet ndihmëse;
6. Të përshkruajë parimin e punës së pompave që përdoren në sistemet hidraulike, (centrifugale, me ingranazhe, me fletë, me piston, etj.);
7. Të përshkruajë funksionin e cilindrave hidraulike, shpërndarësve, valvolave të sigurisë, valvolat e rregullimit të prurjes ose presionit, akumulatorët, droselat, filtrat, serbatorët, etj.;
8. Të përshkruajë llojet e hermetizuesve dhe karakteristikat e tyre;
9. Të përshkruajë parimin e punës së kompresorëve, shpërndarësve, valvolave të sigurisë, presionit, rrjedhëse, motorët pneumatikë (rrotullues, linear);
10. Të përshkruajë llojet e tubave dhe elementët lidhës;
11. Të përshkruajë llojet e filtrave dhe përdorimet e tyre;
12. Të përshkruaj testimin e sistemeve hidraulike dhe pneumatike;
13. Të përshkruaj mirëmbajtjen e sistemeve hidraulike dhe pneumatike;
14. Të përshkruaj mekanizmat e komandimit të sistemeve hidraulike dhe pneumatike;
15. Të listojë metodat kryesore të përpunimit të detaleve;
16. Të përshkruajë veçoritë e statikës, kinematikës dhe dinamikës së trupave;
17. Të shpjegojë kuptimin e koncepteve “ngarkesë” dhe “sforcim” i materialeve;
18. Të përshkruajë tolerancat e përmasave dhe shënimin e tyre në vizatime;
19. Të përshkruajë veçoritë e sistemit ISO të tolerancave dhe vendosjeve.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të përzgjedhë detalet, lidhjet, mekanizmat dhe llojet e transmisioneve;

Rr. Mustafa Lleshi, Godina e Thesarit, Kati i tretë, Tiranë Web site www.akafp.gov.al
Tel/fax.+355 42237087

2. Të kryejë kontrolle vizuale dhe dëgjimore në sistemet hidraulike;
3. Të kryejë punime në elementët e sistemeve hidraulike, sipas manualit të prodhues;
4. Të kryejë punime në mekanizmat komandues dhe të shpërndarjes;
5. Të kryejë punime në elementët e sistemeve pneumatike;
6. Të kryejë punime të mirëmbajtjes në sistemet hidraulike dhe pneumatike, sipas manualit të prodhuesit;
7. Të testojë funksionimin e sistemit hidraulik dhe pneumatik pas punimeve të kryera, sipas procedurave përkatëse.

Kriteret e vlerësimit

- Klasifikon materialet që përdoren në makinat bujqësore dhe pajisjeve ndihmese, sipas proceseve të punës;
- Përcakton saktë vetitë fizike, teknologjike dhe mekanike të materialeve;
- Përcakton saktë veçoritë e metaleve, lidhjeve të metaleve dhe materialeve jometalike;
- Zbaton metodat kryesore të përpunimit të detaleve, sipas udhëzimeve;
- Përzgjedh detalet, lidhjet, mekanizmat dhe llojet e transmisioneve, sipas llojit të makinave bujqësore;
- Kryen saktë llogaritje të thjeshta që kanë të bëjnë me ngarkesat dhe sforcimet e materialeve;
- Përcakton saktë tolerancat e përmasave dhe shënimet e tyre, sipas standardit;
- Përcakton saktë tolerancat e vendosjes, sipas standardit;
- Kryen kontrolle vizuale dhe dëgjimore në sistemet hidraulike, sipas procedurave teknike;
- Kryen çmontim/montim dhe riparim/zëvendësim të pompën dhe shpërndarësit hidraulikë, sipas manualit të prodhuesit;
- Kryen çmontim/montim dhe riparim/zëvendësim të pistonave, valvolave dhe cilindrave hidraulikë/ pneumatikë, sipas manualeve të prodhuesit;
- Kryen çmontim/montim dhe zëvendësime të tubacioneve metalike dhe fleksibël, sipas manualeve të prodhuesit;
- Kryen çmontim/montim dhe riparim/zëvendësim të mekanizmave komandues dhe të shpërndarjes, sipas manualeve të prodhuesit;
- Kryen punime pastrimi dhe zëvendësimi në depozita dhe filtrat, sipas procedurave përkatëse;
- Kryen punime pastrimi dhe zëvendësimi në filtrat e ajrit në sistemet pneumatike, sipas procedurave përkatëse;
- Kryen zëvendësimin e lëngut hidraulik, sipas manualit të prodhuesit;
- Kryen punime të mirëmbajtjes në sistemet hidraulike dhe pneumatike, sipas manualit të prodhuesit;
- Teston funksionimin e sistemit hidraulik dhe pneumatik pas punimeve të kryera, sipas

Rr. Mustafa Lleshi, Godina e Thesarit, Kati i tretë, Tiranë Web site www.akafp.gov.al
Tel/fax.+355 42237087

procedurave përkatëse.

NjN-12-III-0539-26 Bazat e elektroteknikës për mjetet bujqësore

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë rëndësinë e elektroteknikës në funksionimin, mirëmbajtjen dhe diagnostikimin e makinerive bujqësore;
2. Të shpjegojë madhësitë kryesore elektrike: tensionin, rrymën, rezistencën, fuqinë dhe energjinë elektrike;
3. Të përshkruajë parimet bazë të qarqeve elektrike të rrymës së vazhduar dhe të rrymës alternative;
4. Të dallojë lidhjet elektrike në seri, në paralel dhe të kombinuara;
5. Të shpjegojë zbatimin bazë të ligjit të Ohmit në qarqet elektrike të thjeshta;
6. Të përshkruajë funksionin e burimeve të energjisë elektrike në makineritë bujqësore;
7. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin bazë të baterisë;
8. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin bazë të alternatorit/gjeneratorit të tensionit;
9. Të përshkruajë funksionin e përcjellësve, terminaleve, konektorëve dhe lidhjeve elektrike;
10. Të përshkruajë funksionin e siguresave, releve, çelësave, ndërprerësve dhe elementeve mbrojtëse;
11. Të përshkruajë funksionin e prizave elektrike për rimorkio dhe pajisje ndihmëse;
12. Të përshkruajë funksionin e sensorëve, aktuatorëve dhe elementeve komandues në makineritë bujqësore;
13. Të dallojë elementët elektrikë nga elementët elektronikë;
14. Të përshkruajë veçoritë kryesore të qarqeve të integruara dhe të printuara në makineritë bujqësore;
15. Të interpretojë simbolet kryesore elektrike dhe elektronike në skema teknike;
16. Të përshkruajë mënyrën e leximit të skemave të thjeshta elektrike dhe elektronike të makinerive bujqësore;
17. Të përshkruajë përdorimin e dokumentacionit teknik, manualeve dhe katalogëve për kontrollin e sistemeve elektrike;
18. Të përshkruajë rregullat e sigurisë gjatë punës me bateri, përcjellës, qarqe, pajisje matëse dhe elemente elektrike.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë matje dhe verifikime në qarqet elektrike të mjeteve bujqësore dhe pajisjeve ndihmwse;
2. Të kryejë punime në lidhjet elektrike në seri, në paralel dhe të kombinuara të sistemit elektrik;
3. Të kryejë punime të mirëmbajtjes në sistemet elektrike të mjeteve bujqësore dhe

Rr. Mustafa Lleshi, Godina e Thesarit, Kati i tretë, Tiranë Web site www.akafp.gov.al
Tel/fax.+355 42237087

pajisjeve ndihmwse.

Kriteret e vlerësimit

- Identifikon madhësitë kryesore elektrike: tensionin, rrymën, rezistencën, fuqinë dhe energjinë elektrike, sipas terminologjisë teknike;
- Përdor njësitë matëse të madhësive elektrike, sipas sistemit ndërkombëtar të njësive;
- Dallon rrymën e vazhduar nga rryma alternative, sipas karakteristikave bazë të tyre;
- Identifikon qarqet elektrike të rrymës së vazhduar dhe të rrymës alternative, sipas skemave të thjeshta elektrike;
- Identifikon lidhjet elektrike në seri, në paralel dhe të kombinuara, sipas skemave të thjeshta elektrike;
- Zbaton ligjin e Ohmit në ushtrime dhe shembuj të thjeshtë teorikë, sipas formulës përkatëse;
- Identifikon burimet e energjisë elektrike në makineritë bujqësore, sipas dokumentacionit teknik;
- Identifikon pjesët kryesore të baterisë, sipas dokumentacionit teknik;
- Identifikon pjesët kryesore të alternatorit/gjeneratorit të tensionit, sipas dokumentacionit teknik;
- Identifikon përcjellësit, terminalet, konektorët dhe lidhjet elektrike, sipas skemave teknike;
- Identifikon siguresat, reletë, çelësat, ndërprerësit dhe elementet mbrojtëse, sipas skemave elektrike;
- Identifikon sensorët, aktuatorët dhe elementet komandues, sipas skemave dhe dokumentacionit teknik;
- Dallon elementet elektrike nga elementet elektronike, sipas ndërtimit dhe funksionit të tyre;
- Identifikon qarqet e integruara dhe qarqet e printuara, sipas dokumentacionit teknik;
- Lexon skema të thjeshta elektrike dhe elektronike të makinerive bujqësore, sipas simboleve dhe shenjave teknike;
- Përdor dokumentacionin teknik, manualet dhe katalogët për elementet elektrike dhe elektronike, sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Identifikon rreziqet kryesore gjatë punës me bateri, përcjellës, qarqe, pajisje matëse dhe elemente elektrike, sipas rregullave të sigurisë;
- Zbaton rregullat bazë të sigurisë elektrike, sipas procedurave teknike;
- Zbaton rregullat e mbrojtjes në punë gjatë veprimtarive që lidhen me sistemet elektrike të makinerive bujqësore, sipas standardit.

NjN-12-III-0540-26 Planifikimi dhe organizimi i punës në mekanikën bujqësore

Rezultatet e të nxënit në njohuri

Rr. Mustafa Lleshi, Godina e Thesarit, Kati i tretë, Tiranë Web site www.akafp.gov.al
Tel/fax.+355 42237087

1. Të përshkruajë legjislacionin në fuqi në fushën e mekanikës bujqësore;
2. Të përshkruajë strukturën organizative të një servisi për makinat bujqësore;
3. Të shpjegojë rëndësinë e makinerive bujqësore në zhvillimin e bujqësisë dhe kërkesave të tregut;
4. Të shpjegojë tendencat e zhvillimet të fushës së mekanikës bujqësore në Shqipëri;
5. Të shpjegojë planin e organizimit të punimeve dhe mënyrat e zbatimit të tij;
6. Të shpjegojë mënyrat e planifikimit të proceseve të punës dhe bazës materiale;
7. Të argumentojë rëndësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore;
8. Të shpjegojë rëndësinë e vendosjes dhe respektimit të radhës së punës në punimet që do të kryen;
9. Të përshkruajë ndarjen e detyrave, sipas proceseve/prioriteteve të punës;
10. Të argumentojë rëndësinë e organizimit të vendit të punës në mënyrë ergonomike;
11. Të rendisë llojet e mjeteve, makinerive dhe pajisjeve në punime duke shpjeguar përdorimet e tyre;
12. Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të funksionalitetit të makinerive, mjeteve dhe pajisjeve të punës;
13. Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të mjeteve, materialeve, pajisjeve për pastrimin e veglave dhe vendit të punës;
14. Të shpjegojë rëndësinë e sistemimit dhe pastrimit të vendit të punës para, pas dhe gjatë punës;
15. Të shpjegojë elementët e një urdhri pune dhe mënyrën e zbatimit të tij, sipas rregullores së brendshme;
16. Të vlerësojë rëndësinë e koordinimit dhe bashkëpunimit me eprorët dhe me specialistë të tjerë për mbarëvajtjen e punës;
17. Të shpjegojë llojet e dokumentacionit teknik dhe financiar dhe përdorimet e tyre në mekanikën bujqësore.
18. Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrat e raportimit për ecurinë e punës;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të organizojë vendin e punës në mënyrë ergonomike;
2. Të zbatojë radhën e punës për detyrën e dhënë;
3. Të kryejë kontrollin e funksionalitetit të makinave bujqësore, mjeteve dhe pajisjeve të punës;
4. Të përdorë mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, si dhe instrumentet matës dhe kontrolluese;
5. Të kryejë pastrimin dhe sistemimit të vendit të punës, mjeteve dhe pajisjeve përkatëse;
6. Të kryejë dokumentimin dhe raportimin tek eprori për punën e kryer.

Kriteret e vlerësimit

- Planifikon veprimtaritë ditore, javore dhe mujore, sipas rëndësisë dhe prioriteteve;

Rr. Mustafa Lleshi, Godina e Thesarit, Kati i tretë, Tiranë Web site www.akafp.gov.al
Tel/fax.+355 42237087

- Përcakton radhën e punës për realizimin e detyrës, sipas proceseve të punës;
- Organizon në mënyrë ergonomike vendin e punës;
- Përzgjedh mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, sipas llojit të shërbimit, sipas proceseve të punës;
- Përgatit makinën bujqësore për shërbim, sipas procedurave përkatëse;
- Kryen kontrollin vizual të makinës bujqësore nga jashtë dhe brenda, sipas procedurave përkatëse;
- Kontrollon funksionalitetit të mjeteve dhe pajisjeve të punës, sipas manualeve përkatëse;
- Zbaton detyrën e dhënë nga eprori, sipas rregullores së brendshme;
- Përdor mjetet, materialet dhe pajisjet e punës, sipas llojit të shërbimit;
- Kryen pastrimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve, pajisjeve dhe vendit të punës, sipas procedurave përkatëse;
- Kryen sistemimin dhe pastrimin e vendit të punës, sipas rregullores së brendshme;
- Bashkëpunon me eprorët dhe kolegët, sipas procedurave përkatëse rregullores së brendshme;
- Plotëson librin e shërbimit të makinave bujqësore dhe pajisjeve ndihmëse, sipas punimeve të kryera;
- Dokumenton në mënyrë periodike punën e kryer, sipas formateve përkatëse;
- Raporton punën e kryer, sipas formateve përkatëse.

NjN-12-III-0541-26 Diagnostikim i parregullsive në sistemet e makinerive bujqësore

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të shpjegojë informacionin teknik dhe parregullsitë e raportuara në makineritë bujqësore;
2. Të shpjegojë historikun e shërbimeve dhe mirëmbajtjes së makinerisë bujqësore;
3. Të interpretojë dokumentacionin teknik, manualet dhe skemat e prodhuesit;
4. Të përshkruajë mënyrat e kontrollit vizual dhe dëgjimor të makinerive bujqësore;
5. Të interpretojë parregullsitë e evidentuara gjatë kontrollit vizual të makinerive bujqësore;
6. Të shpjegojë procedurat e testimit të makinerive bujqësore në ngarkesë;
7. Të interpretojë rezultatet e testimit të makinerive bujqësore në ngarkesë;
8. Të klasifikojë pajisjet matëse, diagnostikuese dhe kontrolluese, sipas funksionit dhe përdorimit të tyre;
9. Të përshkruajë përdorimin e multimetrit, osciloskopit, manometrave dhe pajisjeve të tjera diagnostikuese;
10. Të përshkruajë procedurat për diagnostikimin elektrik/elektonik të sistemeve të makinerive bujqësore;
11. Të interpretojë kodet e gabimeve diagnostikuese të sistemeve elektronike të makinerive

Rr. Mustafa Lleshi, Godina e Thesarit, Kati i tretë, Tiranë Web site www.akafp.gov.al
Tel/fax.+355 42237087

bujqësore;

12. Të përshkruajë procedurat e leximit, regjistrimit dhe fshirjes së kodeve të gabimeve;
13. Të përshkruajë mënyrat e kontrollit të qarqeve dhe elementëve elektrike të tyre;
14. Të interpretojë parametrat e tensionit, rezistencës, vazhdimësisë dhe sinjalit elektrik gjatë diagnostikimit;
15. Të përshkruajë procedurat e kontrollit të lidhjeve elektrike dhe konektorëve;
16. Të klasifikojë llojet e pajisjeve për diagnostikimin e sistemeve hidraulike dhe pneumatike;
17. Të shpjegojë procedurat për diagnostikimin e sistemeve hidraulike dhe pneumatike;
18. Të interpretojë parametrat e presionit, rrjedhjes dhe funksionimit në sistemet hidraulike dhe pneumatike;
19. Të përshkruajë procedurat e regjistrimit dhe raportimit të rezultateve të diagnostikimit;
20. Të interpretojë rezultatet e diagnostikimit për përcaktimin e procedurave të riparimit;
21. Të përshkruajë procedurat e kontrollit dhe testimit pas ndërhyrjes ose riparimit;

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë diagnostikim në sistemet elektrike dhe elektronike të makinerive bujqësore;
2. Të kryejë punime të mirëmbajtjes në sistemet elektrike dhe elektronike të makinerive bujqësore;
3. Të kryejë diagnostikim në sistemet hidraulike dhe pneumatike të makinerive bujqësore;
4. Të kryejë punime të mirëmbajtjes në sistemet hidraulike dhe pneumatike të makinerive bujqësore.

Kriteret e vlerësimit

- Analizon parregullsitë dhe ankesat e raportuara për sistemet e makinerive bujqësore, sipas informacionit teknik;
- Analizon historikun e shërbimeve dhe mirëmbajtjeve të makinerisë bujqësore, sipas dokumentacionit teknik;
- Zbaton dokumentacionin teknik, manualet dhe skemat, sipas sistemit përkatës;
- Kryen kontrollin vizual dhe dëgjimor të sistemeve të makinerive bujqësore, sipas procedurave teknike;
- Përcakton parregullsitë dhe shenjat e defekteve gjatë diagnostikimit;
